



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:261659
Datë: 30.03.2024
Numri i dokumentit: 05528947

KPPP.nr.1990/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Objekti Afarist-Qendra Tregtare, Prishtinë – Mitrovicë, “Zakuk”, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbare, jashtë seancës, me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë – dega në Vushtrri për të vendosur në çështjen juridike përmbare në mes të kreditorit Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës, dhe debitorit Objekti Afarist-Qendra Tregtare.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – dega në Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr.966/2013, të datës 26.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbare, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë – dega në Vushtrri, për arsytet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbare më është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Ndërsa, mjetet juridike në procedurë përmbare, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbare (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbare, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa”*, ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbare. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbare përmbare me dhunë”*.

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbare sipas propozimit për përmbare të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbare të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbare.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbare është caktimi dhe zbatimi i përmbare nga gjykata si organ përmbare sipas propozimit për përmbare të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se Gjykata Themelore në Mitrovicë – dega në Vushtrri është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbare, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa u tha më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1990/23, datë 28.03.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.